



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Plani i Integruar i Ministrisë 2008

Shkurt 2008

Mesazhi i Ministrit

Ministria e Shëndetësisë po ndërmerr reforma të thella për modernizimin e sistemit shëndetësor dhe rritjen e cilësisë së tij të shërbimeve, kapacitetet profesionale dhe pajisjen me teknologji të lartë. Pjesë e reformave është riorganizimi i sistemit shëndetësor, rritja e peshës dhe rolit të sigurimeve shëndetësore, zgjerimi i rrjetit publik, mbështetja prioritare për spitalet rajonale, si dhe krijimi i hapësirave të nevojshme për nxitjen e nismave private në sektor. Qëllimi ynë është krijimi i një sistemi efektiv, të mirëmenaxhuar dhe të aftë të ofrojë kujdes shëndetësor për të gjithë qytetarët.



Ne po punojmë bashkërisht me institucionet tona dhe me partnerët tanë ndërkombëtarë për harmonizimin e projekteve dhe prioriteteve, për të përmbushur në kohë dhe me cilësi angazhimet që burojnë nga Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë. Dokumenti i Planit të Integruar të Ministrisë së Shëndetësisë do të shërbejë si një faktor nxitës dhe referues për zbatimin dhe ndjekjen e këtyre aktiviteteve në sektorin shëndetësor.

Synim unë mbetet ndërmarrja e të gjitha reformave dhe masave të nevojshme që garantojnë përmbushjen e detyrimit tonë kushtetues për kujdes shëndetësor për qytetarët, si dhe e afrojnë sistemin tonë shëndetësor me atë të vendeve anëtare të Bashkimit Europian.

Nard Ndoka

A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke.

Ministër i Shëndetësisë

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë	4
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	5
3	Programet buxhetore të Ministrisë	6
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008.....	7
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë	11
Aneks 1	Projekt-ligjet për t'u paraqitur	12
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European	13
Aneks 3	Investimet publike	15
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	17
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit	19

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Shëndetësisë ka për mision hartimin dhe është përgjegjëse për zbatimin e politikave e strategjive të zhvillimit në sistemin shëndetësor, për rregullimin e tij si dhe për koordinimin e të gjithë aktorëve brenda dhe jashtë sistemit shëndetësor.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e shëndetësisë

Dokumenti është diskutuar në Komitetin e Planifikimit Strategjik dhe po punohet për përmirësimin e tij duke përfshirë dhe parashikimin e shpërndarjes së burimeve financiare afatmesme dhe afatgjata mbi bazën e kostimit të politikave. Më pas do të vazhdohet procedura e miratimit në Këshillin e Ministrave.

Strategjia ndërsektoriale e mbrojtjes së konsumatorit

Bazuar në kuadrin ligjor ekzistues dhe të përmirësuar (Ligji “Për Ushqimin”) dhe në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së, veçanërisht Strategjinë e Politikave për Konsumatorët të BE-së (2007-2013), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Shëndetësisë zhvilluan strategji individuale për mbrojtjen e konsumatorit (2007-2013), të cilat më pas u integruan në dokumentin e strategjisë së përbashkët. Në strategjinë e përbashkët janë përpiluar vizioni, prioritetet strategjike, strukturat, buxheti dhe afatet kohore. Ministria e Shëndetësisë ka dhënë kontributin e saj në të tëra fazat e zhvillimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorit.

Qëllimet

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Krijimi i një kuadri ligjor të plotë dhe modern, një sistem financimi adekuat, burime njerëzore të afta për t’u përgjigjur nevojave të sistemit shëndetësor dhe një sistem informacioni të plotë në të gjitha nivelet e shërbimit shëndetësor.
- Akses më i mirë për KSHP dhe ofrimi i shërbimeve sipas normave dhe standarteve të përcaktuara nëpërmjet rritjes së autonomisë së QSH.
- Mbulimi me ambulanca i 100% të territorit të vendit, deri në vitin 2015.
- Reduktimi i niveli të vdekshmërisë së fëmijeve nën 5 vjeç, në 10/1000 lindje të gjalla deri në 2015 në krahasim me 20/1000 lindje të gjalla për vitin 2001.
- Reduktimi i vdekshmërisë amtare në vitin 2015, me 1/2 nga 2001 (22,7 vdekje për 100 000 lindje të gjalla)
- Edukimi i 90% të popullsisë, mbi principet e kujdesit shëndetësor të gojës dhe përfitimi nga fluorizmi i 90% të grupmoshës 0-6 vjeç, deri në vitin 2015.
- Ofrimi i modeleve bashkëkohore të manaxhimit të spitaleve i mbështetur nga sisteme të zhvilluara informacioni klinik dhe financiar si dhe ngritjen e sistemit të monitorimit i cili do të masë performancën spitalore dhe do të lejojë akreditimin e spitaleve. Fuqizimi dhe optimizimi i shërbimeve ekzistuese.
- Riorganizimi i shërbimit të transfuzionit dhe akreditimi i këtij shërbimi deri në 2010.
- Sigurimi me vakcina dhe imunizimi me vakcina të detyrueshme të mbajtur respektivisht në nivelet 100% dhe mbi 95%. 0 raste me poliomielit dhe fruth. Vetëm raste të rralla dhe sporadike për rubeolën, difterinë dhe tetanozin. Seropozitiviteti i hepatit B tek fëmijët nën 1 vjeç i ulur.
- Ulja çdo vit në masën 5% e numrit të disa infeksioneve me burim ujini si rezultat i survejancës së sëmundjeve infektive dhe monitorimit të ujit të pijshëm.
- Laboratorët e shëndetit publik të fuqizuar totalisht deri në vitin 2015.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij Programi konsiston në përmirësimin e strukturës funksionale për një menaxhim adekuat të sistemit shëndetësor; hartimin e dokumentave politike, strategjive dhe planeve kombëtare të zhvillimit të sistemit shëndetësor; ruajtjen e integritetit të piramidës së shërbimeve shëndetësore duke forcuar drejtoritë e shëndetit publik në nivel qarku; akreditimin, inspektimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sektorit shëndetësor.

3.2 SHËRBIMET E KUJDESIT PARËSOR

Politika e këtij Programi konsiston në ofrimin e shërbimeve cilësore të kujdesit shëndetësor parësor të bazuar në komponentet e kujdesit kurativ, parandalues dhe promocial.

3.3 SHËRBIMET E KUJDESIT DYTËSOR

Politika e këtij Programi konsiston në ofrimin e Kujdesit Spitalor në të gjitha nivelet për një akses më të mirë, cilësi të kënaqshme dhe menaxhim kosto efektiv të këtij shërbimi. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve me anën e aplikimit të udhëzuesve të praktikës klinike, sistemit të akreditimit, trajnimit të personelit, vlerësimit të teknologjisë mjekësore dhe të performancës me anë të treguesve përkatës.

3.4 SHËNDETI PUBLIK

Politika në shërbimet e shëndetit publik konsiston në ruajtjen, përmirësimin e shëndetit të popullatës, parandalimin e sëmundjeve infektive dhe kronike nëpërmjet sistemit të survejancës dhe zbatimit të masave dhe programeve përkatëse në fushën e shëndetit publik në bashkëpunim me shërbimin e mjekësisë familjare.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Ngritja e sistemit të informacionit për burimet njerëzore.
- Kategorizimi i ri për shërbimin infermieristik i ngritur.
- Shtrirjen e praktikës me qëllim vlerësimin e performancës së spitaleve me anë të treguesve përkatës.
- Zbatimi i planit afat-shkurtër të përafrimit të legjislacionit.

Produktet që do të ofrohen:

- 11% të nevojave të plotesuara me pajisje mobilimi dhe zyrë;
- 7% të nevoja të plotësuara me ambjente të rikonstruara;
- 8 Projekte të reja të bëra zbatimi për ndërtime të reja dhe rikonstruksione.
- 1 Projekt i mbështetur me kontributin e kostos lokale;

4.2 SHËRBIMET E KUJDESIT PARËSOR

Objektivat e politikës

- Mbulimi çdo vit me ambulanca i 10% të fshatrave
- Plotësimi çdo vit në 10% i QSH, me pajisje zyre.
- Pëmirësimi në 4% i totalit të infrastrukturës të shërbimit stomatologjik publik
- Mbulimi me shërbime parandaluese të 7% të popullsisë çdo vit.
- Përfundimi i sistemit të informacionit në KSHP për 6 qarqe.
- Trajnimi i mjekut të familjes në 5 qarqe.
- Rritja në masën 10% e kontributit të buxhetit për sigurimin e kontraktivëve në shërbimet publike të planifikimit familjar.

Produktet që do të ofrohen

- 4,900,000 Vizita të kryera nga njësitë e kujdesit shëndetësor parësor;
- 54,000 Vizita obstetrikale të kryera në këshillimoret e grave;
- 1,010,000 Vizita të kryera në këshillimoret e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç;
- 303,000 Fëmijë deri në 18 vjeç të trajtuar në shërbimin stomatologjik;
- 10% Rritja e masës së financimit nga buxheti i shtetit për sigurimet shëndetësore;
- 18 Projekte të reja të bëra; zbatimi për ndërtime të reja dhe rikonstruksione
- 5% e nevojave të plotësuara me pajisje mjekësore;
- 15% e nevojave të plotësuara me ambjente të rikonstruara;
- 1 Projekt i mbështetur me kontributin e TVSH & detyrimin doganor;

- 5 Poliklinika të rehabilituara; (2 në Tiranë, Korçë, Gjirokastrë, Peshkopi)
- 5% e nevojave të plotësuara me pajisje mobilimi dhe zyre;

4.3 SHËRBIMET E KUJDESIT DYTËSOR

Objektivat e politikës

- Përmirësim i manaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare në spitalet universitare të Tiranës.
- Plotësim në masën 70% i nevojave me medikamente për shërbimin e onkologjisë, hematologjisë, sipas skemave të miratuara nga OBSH.
- Trajtimi për hemodializë me të gjithë komponentët i 20% më shumë pacientëve.
- Dyfishim i procedurave diagnostike dhe terapeutike (numri i ndërhyrjeve) në sëmundjet koronare të zemrës.
- Plotësimi i nevojave me gjak dhe produkte të tij me një cilësi dhe siguri më të lartë të mundshme.
- Planifikimi dhe sigurimi i barnave dhe materialeve të mjekimit në përputhje me nevojat më prioritare të spitaleve
- Përmirësimi i kushteve jetësore në spitalet psikiatrike dhe trajtimi riaftësues terapeutik dhe jo nga ekipe multidisiplinare .
- Ngritja e tre shtëpive mbështetëse me nga 10 shtretër për të sëmurët kronikë 3 në Shkodër,

Produktet që do të ofrohen:

- 84,000 Pacientë të trajtuar në shërbimin e patologjisë;
- 68,000 Pacientë të trajtuar në shërbimin e Kirurgjisë;
- 57,000 Pacientë të trajtuar në shërbimin e pediatriisë;
- 76,000 Pacientë të trajtuar në shërbimin e obsteri-gjinekologjisë;
- 8,000 Pajisje dhe infrastruktura spitalore të mirëmbajtura;
- Shërbime mbështetëse në spitalet e vendit të siguruara;
- 15% të nevojave të plotësuara me ambjente të rikonstruktura;
- 23 Projektme të reja të bëra;
- Spitale të rehabilituar nga ana fizike;
- 10 % e nevojave të plotësuara me pajisje mjekësore;
- 6% të nevoja të plotësuara me pajisje mobilimi dhe zyrë;
- 4 Projekte të mbështetura me kontributin e TVSH & detyrimi doganor;
- 2 Spitale të reja : Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” mjekësia interne, Spitali Kavajë.

4.4 SHËNDETI PUBLIK

Objektivat e politikës

- Përgatitja e listës së indikatorëve të shëndetit mjedisor.

- Përgatitja e udhëzuesit të hetimit të shpërthimeve epidemiologjike.
- Përmirësimi i raportimit të sëmundjeve të caktuara, proporcioni i rretheve që raportojnë në kohë dhe me cilësi të lartë i rritur me 10% çdo vit.
- Ngritja profesionalisht e 10% të epidemiologëve, inspektorëve sanitarë dhe profesionistëve të shëndetit publik, në fushat përkatëse.

Produktet që do të ofrohen

- 50 000 Fëmijë të vaksinuar;
- 62 400 Vrojtme të kryera për kontrollin e situatës epidemiologjike;
- 12 Laboratorë të shërbimeve të shëndetit publik të mirëmbajtur;
- 1 Raport përmbledhës i indikatorëve;
- 110 Raste me HIV/AIDS në kujdes mjekësor;
- 24 Kontrollë mjedisore (ujë, ajër, etj);
- 15 Aktivitete promovuese në vit;
- 10% të nevojave të plotësuara me pajisje mjekësore;
- 7% të nevojave të plotësuara me pajisje mobilimi dhe zyrë;
- 8% të nevojave të plotësuara me ambjente të rikonstruara;

Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, million Lek

Programet	Pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore	Mallra dhe shërbime 602	Subveçionet 603	Të tjera transfertet korrente 604, 605	Transferta për buxhetet familiare dhe individët 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Programet	600, 601						
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	137	70	0	3	0	178	388
Shërbimet e Kujdesit Parësor	1,128	278	0	5,867	0	1,743	9,016
Shërbimet e Kujdesit Dytësor	6,186	5,108	0	0	0	2,853	14,147
Shërbimet e Shëndetit Publik	536	205	0	50	0	67	858
Total	7,987	5,661	0	5,920	0	4,841	24,409

5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Numri i ambulancave të ndërtuara/rikonstruara	Ambulancë	Përmirësim i cilësisë dhe aksesibilitetit
Numri i mjekëve të përgjithshëm të trajnuar për mjekësi familjare	Mjek	Përmirësim i cilësisë
Niveli i vdekshmërisë foshnjore	Vdekje për 1000 lindje të gjalla	Përmirësim i kujdesit prenatal, obstetrikal dhe postnatal
Niveli i vdekshmërisë amtare	Vdekje për 100 000 lindje të gjalla	Përmirësim i cilësisë së shëndetit riprodhues
Niveli i mbulesës vaksinale	Përqindje (raporti i të vaksinuarve me popullatën target)	Kontroll i sëmundjeve infektive
Shfrytëzimi i shtratit	Përqindje (raporti i shfrytëzimit në ditë/kohëzgjatja e periudhës)	Përmirësimi i efikasitetit të spitaleve
% e sectio cesarea	% (Raporti i numrit të lindjeve me s.c./numri total i lindjeve)	Monitorimi i sigurisë së lindjes
Niveli i vetëmjaftueshmërisë me gjak	Numri i dhurimeve për 1000 banorë.	Arritja e vetëmjaftueshmërisë kombëtare
Plotësimi i nevojave me gjak/produkte	Përqindje (rapoti i numrit të kërkesave/numrin e kërkesave të plotësuara)	Arritja e vetëmjaftueshmërisë kombëtare
Raste të infektuara me agjentë infektivë të transmetueshëm me anë të transfuzionit	Numër	Monitorimi i sigurisë së gjakut

Aneks 1 Projekt-ligjet për t'u paraqitur

- Projekt Ligj “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.
- Projekt Ligj “Për Financimin e Kujdesit Shëndetësor”.
- Projekt Ligj “Për Shëndetin Publik”.
- Projekt Ligj “Për mbrojtjen nga alkoolët”,
- Projekt Ligj “Për shërbimin farmaceutik”.
- Projekt Ligj “Për pajisjet mjekësore në RSH”
- Projekt Ligj “Për parandalimin e HIV/AIDS në Shqipëri”
- Projekt Vendim “Për liçensimin e veprimtarisë private në fushën e shëndetësisë”.
- Projekt Vendim “Kriteret e hapjes dhe mbylljes së spitaleve”
- Projekt Vendim “Për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit”.
- Projekt Vendim “Për statusin e Institutit të Shëndetit Publik”.
- Projekt Vendim “Për rishikimin e rregullores mbi përdorimin e sigurt të materialeve radioaktive”.
- Projekt Vendim “Për rishikimin e rregullores mbi liçencimin dhe inspektimin”.
- Projekt Vendim “Për miratimin e strategjisë kombëtare për politikën e kontrollit të alkoolit”.
- Projekt Vendim “Për mbrojtjen nga produktet e duhanit”.
- Projekt Vendim “Për miratimin e strategjisë kombëtare për politikën e kontrollit të duhanit”.
- Projekt Vendim “Për krijimin e shërbimit psikosocial në sistemin shëndetësor për dhënien e ndihmës psikosociale viktimave të dhunës në familje”.
- Projekt Vendim “Për kushtet dhe mënyrat e liçencimit, për përcaktimin e strukturave që do të kryejnë inspektimin e qendrave të fraksionimit të plazmës dhe prodhimit të derivateve të gjakut”.
- Projekt Vendim “Për zbatimin e ligjit për pajisjet mjekësore”
- Projekt Vendim “Për planifikimin e fondeve për veprimtaritë, promovuese dhe edukative, në fushën e transfuzionit të gjakut” “Për përdorimin e fondeve për motivimin e dhuruesve të gjakut”.

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin European

- Projekt urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për hartimin dhe zbatimin e skemës së hemovigjilencës”.
- Projekt urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për përcaktimin e rregullave për vlerësimin e cilësisë dhe të sigurisë së gjakut e të produkteve të tij”
- Projekt urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e sistemit të transfuzionit të gjakut”.
- Projekt VKM “Për kushtet dhe mënyrat e licënsimit, krijimit e të funksionimit të qendrave të fraksionimit të plazmës dhe prodhimit të derivateve të gjakut”.
- Projekt urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për planifikimin e fondeve për veprimtaritë, promovuese dhe edukative, në fushën e transfuzionit të gjakut” .
- Projekt VKM “Për përcaktimin strukturave që do të kryejnë inspektimin e qendrave të fraksionimit të plazmës dhe prodhimit të derivateve të gjakut”.
- Projekt urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për përdorimin e fondeve për motivimin e dhuruesve të gjakut”.
- Projekt urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për miratimin e rregullores për procedurat e inspektimit në shërbimin e transfuzionit”.
- Projekt urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për procedurat dhe kriteret e akreditimit për strukturat e shërbimit të transfuzionit”.
- Projekt urdhër i Ministrit të Shëndetësisë “Për ndërtimin e sistemit informativ në shërbimin kombëtar të transfuzionit”.
- Projekt VKM “Për standardet kombëtare për produktet, e prodhuara dhe të ofruara, nga
- Projekt VKM “Për kushtet për hapjen dhe funksionimin e bankave të gjakut të kordonit umbilikal, për qëllim transplantit”.
- Krijimi i njësisë së hemovigjilencës në Tiranë.
- Projektvendim për zbatimin e ligjit “Për pajisjet mjekësore”.
- Ngritja brenda strukturës së Ministrisë së Shëndetësisë e Autoritetit Kompetent për pajisjet mjekësore dhe ngritja e Agjencisë Shtetërore të Pajisjeve Mjekësore si domosdoshmëri e zbatimit të kërkesave të legjislacionit përkatës.
- Ngritja dhe fuqizimi i Njësisë së Inxhinierisë Klinike në nivel spitali.
- Projekt Ligj “Për shërbimin farmaceutik”.
- Ngritja e kapaciteteve për praktiken e mirë të fabrikimit.
- Projekt VKM “Për miratimin e strategjisë kombëtare për politikën e kontrollit të duhanit”.
- Ngritja e laboratorit për kontrollin e produkteve të duhanit
- Trajnime me mësuesit e shkollave 9-vjeçare për kontrollin e duhanit (peer educator).
- Trajnime me studentet e fakultetit të mjekësisë dhe mjekë të shërbimit parësor për të ndihmuar duhanpirësit në lënien e duhani.
- Ngritja e strukturave lokale për kontrollin e duhanit.

- Projekt VKM “Për miratimin e strategjisë kombëtare për politikën e kontrollit të alkoolit”
- Riorganizim i komisionit të mbrojtjes nga rrezatimi.
- Rishikim i rregullores mbi përdorimin e sigurtë të materialeve radioaktive.
- Rishikim i rregullores mbi licencimin dhe inspektimin e materialeve radioaktive.
- Amendimi i ligjit “Për parandalimin e përhapjes së infeksionit HIV/AIDS në RSH”.
- Përmirësimi i mirëmbajtjes së sistemit ALERT.
- Trajnime në fushën e veprimtarisë së inspektoratit sanitar shtetëror

Aneks 3 Investimet publike

Emërtimi i projektit të investimit	Projekt buxheti <i>(në lekë)</i> 2008
BUXHETI i SHTETIT - MINISTRIA E SHËNDETËSISË	2.680.008.000
PLANIFIKIM-ADMINISTRIM-MENAXHIM	177.000.000
APARATI I MINISTRISË SË SHËNDETËSISË	177.000.000
Rikonstruksioni+shtesa e godinës së Ministrisë së Shëndetësisë-vazhdim	151.000.000
Projekt-preventiv zbatim për ndërtimin e godinës së të semureve akutë për sp.Shkodër	1.000.000
Projekt-preventiv zbatim për përshtatje të god së ish-kaldajave për Poliklinikën e Lagjes nr.8	1.000.000
Supervizion+kolaudim i rikonstruksionit të godinës së M-SH faza II	2.000.000
Pagesë e lejes së ndërtimit për rikonstruksionin e god . Së M-SH(faza II)	6.000.000
Blerje pajisje mobilimi për Planifikim-Menaxhim	5.000.000
Blerje pajisje elektronike, teknologjike për Planifikimi-Menaxhim	3.000.000
Informatizimi i arkiv-protokollit, sistemi i menaxhim të dok. (DMS) aparati i M-SH	5.000.000
Kosto Lokale Aparati i Min. Shëndetësisë(Njësia e zbatimit P.I.U)	3.000.000
Blerje pajisje të ndryshme për QKCSA Tiranë	1.000.000
SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR	797.844.000
Rikonstruksion dyer-dritare për Kl.Qeveritare	3.200.000
Supervizion kolaudim për rikonstruk e dyer-dritareve KL.Qeveritare	120.000
Rikonstruksion + 2 kate shtesë për punktin e gjakut dhe DSHP Krujë(nga 2007)	10.000.000
Supervizion+kolaudim për rikons+2 kate shtesë per punktin e gjakut DSHP Krujë	450.000
Ndërtim i shtesës së katit të DSHP Shkodër	21.200.000
Supervizion kolaudim për ndërtimin e shtesës së katit DSHP Shkodër	450.000
Supervizion kolaudim për objektet e shërbimit parësor(rrethe)-ASHR Tiranë	724.000
Sistemi i Informacionit për Kujdesin Shëndetësor Parësor (DSHPQ)-ASHR Tiranë	50.000.000
Projekt-preventiva për parësorin	10.000.000
Blerje pajisje mjekësore për Objektet e Shërbimit Parësor	151.000.000
Blerje pajisje mobilimi për Parësorin	25.000.000
Blerje pajisje elektrike, elektroteknike, teknologjike për DSHP në rrethe	5.700.000
INVESTIMET E GRANTIT KONKURUES	380.000.000
Të ardhurat-Parësori	20.000.000
TVSH-DET.DOG. PARËSORI+Kosto Lokale	120.000.000
SHËRBIMI I SHËNDETIT PUBLIK	66.864.000
Rikonstruksioni i godinës 2-kat të promocionit(vazhdim) ISHP Tiranë	12.300.000
Supervizion kolaudim për Rikonstruk e god 2-kat të promocionit ISHP	250.000
Supervizion kolaudim për objektet e higjenës në rrethe për v.2008	914.000
Projekt-preventiva për DHE	5.000.000
Aparatura Mjekësore për DHE	35.100.000
Blerje pajisje mobilimi për higjenën në rrethe	4.000.000
Blerje pajisje elektrike, elektroteknike, teknologjike për higjenën në rrethe	3.300.000

Të ardhurat e Shëndetit Publik	6.000.000
SHËRBIMIT I KUJDESIT DYTËSOR	1.638.300.000
Rikonstruksion i morgut të spitalit Devoll	300.000
Rikonstruksioni i repartit të pediatriisë sp.Fier (nga 2007)	10.000.000
Rikonstruksioni i brendshëm i ambienteve të sp.Gjirokaštër-(faza e tretë)	46.000.000
Sistemi i furnizimit me gaze mjekësore sp.Gjirokaštër	10.500.000
Instalimi i sistemit elektrik+sinjalistika për sp.Gjirokaštër(nga 2007)	10.000.000
Instalimi i pompave të ujit teknologjik për sp.Gjirokaštër	2.000.000
Rikonstruksion i god.infektivit për përshtatje për Sanatorium sp.Korcë	35.000.000
Rikonstruksion i rrjetit hidro-sanitar për spitalin Kukës	10.000.000
Rikonstruksion në godinën e spitalit Krujë(për përfundim nga 2007)	19.816.000
Rikonstruksioni i godinës Nr.3(përfundim) sp.Lushnjë	25.200.000
Ndërtim i rrjetit të KUZ spitali Mat	5.000.000
Asfaltim i sheshit të spitalit Mat	4.000.000
Rikonstruksion i god. së shëndetit riprodhues Pukë(për përfundim nga 2007)	3.500.000
Ndërtim i murit mbajtës 150ml për urgjencën e re (rrezik shembje) sp.Sarandë	5.000.000
Ndërtim i Maternitetit të ri sp.Sarandë	10.000.000
Rikonstruksion i ambienteve të spitalit për përshtatje për maternitet sp.Skrapar	9.000.000
Ndërtimi i shtëpive MIMOZA për të sëmurët mendorë (copë-3)	60.000.000
Rikonstruksion i sistemit të ngrohje-ventilim për QKT.Gjakun Tiranë	10.000.000
Instalim i rrjetit kompiuterik për QKTGjakun Tiranë	5.000.000
Rikonstruksion i S.U.S.M "Shefqet Ndroqi" Tiranë - vazhdim	100.000.000
Rikonstruksion+shtesa e re e spitalit Neurokirurgjisë QSUT	50.000.000
Rikonstruksion i spitalit Pediatrik, QSUT	50.000.000
Rikonstruksion i 8/1	12.000.000
Rikonstruksion i bodrumeve të Neurologjisë	20.000.000
Projekt-preventiva zbatimi për objektet e shërbimit spitalor	58.644.000
Blerje pajisje mjekësore për spitalet e rretheve	444.730.000
Blerje pajisje mobilimi për objektet e spitaleve në rrethe	43.600.000
Blerje pajisje elektrike, elektroteknike, teknologjike	46.100.000
TË ARDHURAT DYTËSORE PËR SH.SPITALOR	20.000.000
TVSH-DET.DOGANOR+K.LOKALE PËR SH.SPITALOR	512.910.000
FINANCIMI I HUAJ	2.160.000.000
Shërbimi i Kujdesit Parësor	945.000.000
Projekti i modernizimit të sistemit shëndetësor	330.000.000
Rikonstruksion dhe pajisje 5 poliklinikave	615.000.000
Shërbimi i Kujdesit Dytësor	1.215.000.000
Projekti për Fazën e Parë të QSUT	826.600.000
Projekti për Spitalin e Përgjithshëm Kavajë	290.000.000
Projekti për Fazën e III të Spitalit Rajonal Shkodër	98.400.000

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

- Programi PRO Shëndetit “Përmirësimi i Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri”, financuar nga USAID, zbatuar nga University Research Co., LLC. Faza I: 2003-2006; Faza II: 2006-2009.
- Programe në fushën e planifikimit familjar (2 projekte), financuar nga USAID dhe zbatuar nga JSI dhe JHPIEGO.
- Programi për parandalimin e gripit të shpendëve, financuar nga Banka Botërore.
- Program për forcimin e kapaciteteve në Kujdesin Shëndetësor Parësor, financuar nga Banka Botërore.
- Programe në fushën e shëndetit riprodhues (survejanca e IST, survejanca e abortit, survejanca e keqformimeve të lindura, siguria e kontraktivëve, studimi “Demografic Health Survey) financuar nga UNFPA.
- Programe në fushën e shëndetit të fëmijës, nutricionit, parandalimit të gripit të shpendëve si dhe studimi “Demografic Health Survey , financuar nga UNICEF.
- Programe për forcimin e kontrollit të sëmundjeve jo-infektive, përmirësimin e survejancës së statusit të imunizimit të popullatës dhe transferimi i njohurive dhe aftësive për realizimin e transplantit të veshkave, në kuadrin e INTERREG 3.
- Projekti 3 vjeçar (2008-2010) “Zhvillimi i mjekësisë transfuzionale sipas standardeve të cilësisë së komunitetit europian” financuar nga Ministria e Jashtme Italiane, zbatuar nga Shkolla Europiane e mjekësisë transfuzive.
- Projekti “Rikonfigurimi i sistemit shëndetësor” financuar nga Banka Botërore.
- Projekti “Zhvillimi i autonomisë së institucioneve shëndetësore” financuar nga Banka Botërore.
- Projekti “Menaxhimi i integruar i sëmundjeve të fëmijërisë në Tropojë” me mbështetjen e UNICEF
- Projekti “Përmirësimi i shëndetit të nënës dhe fëmijë” (OBSh/Qeveria e Spanjes)
- Projekti “Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit parësor për menaxhimin e HIV/AIDS” me mbështetjen financiare të SIDA dhe implemetuar nga Partnerships in Health/MSH
- Projekti “Përgatitja e moduleve dhe trajnimi i mjekut të familjes për menaxhimin e pamjaftueshmërisë jodike” I mbështetur nga UNICEF
- Projekti “Mijetesa e fëmijëve” në qarkun e Dibrës financuar nga USAID dhe I implemtuar nga Kryqi I kuq Amerikan dhe Shqiptar në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë
- Projektet rajonale (Europa Juglindore) në kuadër të Iniciativës për Kohesion Social të Paktit të Stabilitetit
- Rrjeti i Shëndetësisë së Europës juglindore është krijuar në 2001, me nënshkrimin nga Ministrat e Shëndetësisë së rajonit, në Dubrovnik, të Deklaratës së Dubrovnikut, ku vendet e rajonit angazhohen në nivelin më të lartë politik të bashkëpunojnë në 7 fusha prioritare të shëndetit publik si: shëndeti mendor, duhani, ushqimi, gjaku dhe nënproduktet e tij, urgjencat mjekësore, sistemet e informacionit shëndetësor, dhe sëmundjet infektive. Shqipëria ka kryesimin e projektit rajonal të Kontrollit të Sëmundjeve Infektive

- Hapja e një qendre komunitare të shëndetit mendor në Korçë me mbështetjen e OBSH-së.
- Ngritja e “shtëpisë së mbështetur” në Vlorë për 10 paciente me mbështetjen e UNDP/ARTGOAL
- Ngritja e “shtëpisë së mbështetur” në Cërrik për 10 paciente me mbështetjen e OBSH-së
- Zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit 2 vjeçar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe OBSH.
- Projekti i ndërtimit të 2 Spitale të reja - Spiali i Sëmundjeve të Brendshme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitali Kavajë.

Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

Reformimi i përgjithshëm i sistemit shëndetësor do të përqendrohet në mënyrë të veçantë në reduktimin e parandalimin e korrupsionit të gjerë që ka prekur këtë sektor të rëndësishëm. Reformat ligjore, institucionale e funksionale do të synojnë veçanërisht reduktimin e korrupsionit të marrëdhënieve që vendosen në këtë sektor (personel mjekësor-pacient, institucion shëndetësor - pagues).

I. Prioriteti parësor synon standardizimin e prokurimit të barnave, pajisjeve e aparaturave mjekësore, investimeve në shërbimin shëndetësor dhe kontraktimit të shërbimeve të tjera.

- Rregullimi i promovimit në zgjedhjen e barnave dhe pajisjeve mjekësore vazhdon të jetë prioritet i Ministrisë së Shëndetësisë. Për plotësimin e këtij angazhimi është shumë i rëndësishëm:
 - Hartimi i protokolleve të mjekimit
 - Hartimi i listës me barnat esenciale
- Lista esenciale e barnave më të përdorshme në shërbimin shëndetësor shqiptar është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me shefat e shërbimeve të Qendrës Spitalore Universitare dhe grupeve të ngritura për këtë qëllim, e rishikuar kjo për përmirësime në çdo vit prokurimi.
- Përsa i përket procesit të prokurimit dhe rritjes së kapaciteteve të administrimit të prokurimeve sqarojmë se këtë vit në Ministrinë e Shëndetësisë është krijuar Drejtoria e prokurimit duke shtuar numrin e specialistëve që do të kryejnë procedurat e prokurimit.
- Konsolidimi i sistemit të regjistrimit të barnave, shpërndarjes në sektorin shëndetësor publik dhe i kontrollit si dhe etiketimi i barnave janë elemente të cilat do të sistemohen me ligjin e ri për barnat dhe shërbimin farmaceutik rishikimi i të cilit është parashikuar brenda këtij viti.

II. Gjithashtu, një prioritet tjetër strategjik është reduktimi i ndjeshëm i veprimtarive ekonomike informale nga operatorët e sistemit shëndetësor.

- Përcaktimi i një strategjie të qartë dhe me afate e rritje progresive të pagave në sistemin shëndetësor duke kombinuar pjesën e mbuluar nga buxheti i shtetit me pjesën që rrjedh nga burimet e siguruara nga vetë sistemi vazhdon të jetë prioritet i Ministrisë së Shëndetësisë. Konkretisht tendenca e rritjeve të pagave në vitet e fundit ka qenë e tillë: Viti 2002 - 15%; 2003 - 9%; 2004 - 12%; 2005 - 11%; 2006 - 20%; 2007 - 21%.
- Inkurajimi i alternativave private dhe promovimi i kontraktimit nga shteti për pagimin e furnizuesve private duke rregulluar konfliktet e interesit, devijimin e detyruar të pacientëve vetëm drejt shërbimeve private, devijimin e kërkesave të operatorëve furnizues, etj. Lidhur më këtë prioritet Ministria e Shëndetësisë ka nxitur shtrirjen e praktikës së kontraktimit me subjektet private për shërbimet e kuzhinës lavanderisë, hotelerisë etj. Një proces i tillë është realizuar në QSUT dhe është duke u shtrirë edhe në institucione të tjera.
- Zhvillimi i sistemit të vlerësimit të kujdesit shëndetësor parësor është bazuar në performancën e qendrës shëndetësore dhe individit në bazë të indikatorëve

shëndetësorë të përcaktuar. Realizimi i tyre përfshihet si kosto e buxhetit të qendrës shëndetësore

- Evitimi i pagesave informale do të realizohet nëpërmjet institucionalizimit të tyre lidhur me kostot reale të shërbimeve. Për individët e siguruar kjo mbulohet nga skema e rimbursimit shëndetësor, ndërsa për të pasiguruarit është llogaritur pagesa për çdo shërbim që pacienti përfiton. Këtu përjashtohen rastet e ndihmës për urgjencën mjekësore dhe kategoritë e tjera të popullatës që përfitojnë nga rimbursimi i shtetit.
- Do të fuqizohet informacioni dhe promovimi i efekteve positive të rimbursimit nga sigurimet shëndetësore për të rritur numrin e individëve të siguruar.
- Do të rritet transparenca në çdo institucion shëndetësor për tarifën e shërbimeve për të pasiguruarit lidhur me koston e çdo shërbimi, përmirësimin e sistemit të referimit dhe të drejtat e pacientit
- Me miratimin e ligjit për “Për krijimin e Urdhrit infermier-mami në Republikën e Shqipërisë”, është ngritur grupi i punës për të bërë parashikimet e nevojshme buxhetore në projektbuxhetin e vitit 2008 për mbështetjen financiare të këtij institucioni.
- Krijimi i sistemeve të pagesave që parandalojnë e shmangin kontaktet e drejtpëdrejta. Janë ngritur në nivel spitali rajonal zyrat e informacionit receptionit dhe Drejtoritë e Spitaleve janë orjentuar drejt forcimit të rolit të tyre.
- Rritja dhe forcimi i sistemit informativ shëndetësor për të drejtat e detyrimet përkatëse në institucionet e kujdesit shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë është duke zhvilluar disa projekte shumë të rëndësishme në fushën e sistemeve informative.
- Institucionalizimi i kartave raportuese të shërbimeve publike dhe kryqëzimi i rezultateve me statistikat zyrtare.
- Rishikimi i sistemit të ankesave të të sëmurëve.